



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-**

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli Asahi Group Holdings Ltd. – Peroni – Grolsch- Meantime-
SABMiller Plc.- Anheuser Busch InBev

Në datën 13 Maj 2016, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të “Aktit të Shit-Blerjes” e nënshkruar midis Asahi Group Holdings Ltd. (Blerësi) dhe Anheuser Busch InBev (Shitësi), më datë 19 Prill 2016, me objekt përfitim të kontrollit , nga Asahi Group Holdings Ltd. të biznesit të birrës një biznes i pavarur, i cili përbëhet nga markat Peroni, Grolsch dhe Meantime , të cilat i përkasin shoqërisë SABMiller Plc.,. Njoftimi është bërë për xhirove vjetore të realizuara nga shoqëritë Birra Peroni Srl dhe Anheuser Busch InBev në Shqipëri.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Asahi Group Holdings Ltd.:** është një shoqëri aktive në prodhimin e pijeve dhe të ushqimit e listuar në bursën e Tokios. Ajo është një nga shoqëritë prodhuese të birrës në Japoni;
- **Anheuser Busch InBev :** një shoqëri e listuar në bursat e Brukselit dhe të New York-ut, është aktive në prodhimin, marketimin dhe shpërndarjen e birrës, “birrës së lehtë” dhe pijeve jo- alkoolike. Në disa shtete shoqëria shpërndan edhe produkte të birrës së prodhuesve të tjerë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenet 2, 10, pika 1, shkronja b), 12, pika 1) të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al